



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO  
**GJYKATA KUSHTETUESE**  
**USTAVNI SUD**  
**CONSTITUTIONAL COURT**

Prishtinë, më 5 janar 2024  
Nr. ref.:RK 2313/24

## **VENDIM PËR REFUZIM TË KËRKESËS**

në

**rastin nr. KI176/22**

Parashtrues

**Gani Bërnjashi**

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit [PAKR. nr. 140/2019] të 17 prillit  
2022 të Gjykatës së Apelit të Kosovës**

### **GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS**

e përbërë nga:

Gresa Caka-Nimani, kryetare  
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar  
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare  
Safet Hoxha, gjyqtar  
Radomir Laban, gjyqtar  
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare  
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar dhe  
Enver Peci, gjyqtar

#### **Parashtruesi i kërkesës**

1. Kërkesa është dorëzuar nga Gani Bërnjashi, me vendbanim në fshatin Karaçevë, komuna e Kamenicës (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës).

## **Vendimi i kontestuar**

2. Parashtruesi i kërkesës konteston kushtetutshmërinë e “vendimit të paspecifikuar” të Gjykatës Supreme, në ndërlidhje me Aktgjykimin [PAKR. nr. 140/2019] e 17 prillit 2022 të Gjykatës së Apelit dhe Aktgjykimin [PKR. nr. 134/2018] e 30 janarit 2019 të Gjykatës Themelore në Gjiilan (në tekstin e mëtejme: Gjykata e Themelore).

## **Objekti i çështjes**

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së “vendimit të paspecifikuar” të Gjykatës Supreme, në ndërlidhje me aktgjykimet e lartcekura të instancave më të ulëta, me të cilat parashtruesi i kërkesës pretendon se i janë shkelur të drejtat dhe liritë themelore të tij të garantuara me Kushtetutë.

## **Baza juridike**

4. Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara], të Kushtetutës, në nenet 22 (Procedimi i kërkesës) dhe 47 (Kërkesa Individuale) të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 25 (Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve) të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).
5. Më 7 korrik 2023, Rregullorja e punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 01/2023, u publikua në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe hyri në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit të saj. Rrjedhimisht gjatë shqyrtimit të kërkesës, Gjykata Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata) i referohet dispozitave të Rregullores së lartcekur, e cila ka shfuqizuar Rregulloren e punës së Gjykatës nr. 01/2018. Lidhur me këtë, konform rregullit 78 (Dispozitat kalimtare) të Rregullores së punës, nr. 01/2023, përjashtimisht, dispozita të caktuara të Rregullores së punës, nr. 01/2018, do të vazhdojnë të zbatohen në lëndët e regjistruara në Gjykatë përpara shfuqizimit të saj, vetëm nëse dhe për aq sa janë më të favorshme për palët.

## **Procedura në Gjykatën Kushtetuese**

6. Më 17 nëntor 2022, parashtruesi i kërkesës dorëzoi kërkesën në Gjykatë.
7. Më 2 dhjetor 2022, Gjykata njoftoi parashtruesin e kërkesës për regjistrimin e kërkesës dhe nga i njëjti kërkoi që të sqarojë saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar me aktet e autoriteteve publike, si dhe kërkesës t’ia bashkëngjitë vendimin e fundit gjyqësor, së bashku me dokumentet tjera relevante.
8. Më 5 dhjetor 2022, Kryetarja e Gjykatës me Vendimin GJR. KI176/22 caktoi gjyqtaren Selvete Gërxhaliu-Krasniqi gjyqtare raportuese dhe me Vendimin KSH. KI176/22 anëtarët e Kolegjit shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Gresa Caka-Nimani (kryesuese), Bajram Ljatifi dhe Remzije Istrefi-Peci.
9. Më 7 dhjetor 2022, Gjykata, bazuar në fletëkthesën e dorëzuar nga shërbimi postar, vërtetoi se parashtruesi i kërkesës nuk ndodhej në adresën e shënuar në formular të kërkesës, por në burg, në vuajtje të dënimit.
10. Më 16 dhjetor 2022, gjyqtari Enver Peci dha betimin para Presidentes së Republikës së Kosovës, me ç’rast filloi mandati i tij në Gjykatë.

11. Më 22 dhjetor 2022, Gjykata ia ridërgoi parashtruesit të kërkesës, shkresën me nr. ref.: 2288/22/drlsa.
12. Më 6 janar 2023, shërbimi postar dorëzoi fletëkthesën në Gjykatë, si dëshmi e pranimit të shkresës nr. ref.: 2288/22/drlsa, nga parashtruesi i kërkesës.
13. Më 14 nëntor 2023, Gjykata shqyrtoi propozimin e gjyqtarës raportuese dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës që kërkesa të refuzohet me procedurë të përshpejtuar.

### **Përmbledhja e fakteve**

14. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës për çështje të njëjtë parashtrroi për herë të dytë kërkesë në Gjykatë. Më parë kishte dorëzuar kërkesën KI87/22, të cilën Gjykata e kishte refuzuar me procedurë të përshpejtuar me Vendimin e 8 shtatorit 2022 për arsye të moskompeltimit me dokumentacion relevant.
15. Parashtruesi i kërkesës për të njëjtën çështje penale, më 17 nëntor 2022, dorëzoi kërkesën e dytë KI176/22, nga e cila rezulton se Prokuroria Themelore në Gjiilan, kishte ngritur aktakuzë ndaj tij mbi dyshimin e bazuar se kishte kryer veprën penale “*Vrasje e rëndë*” nga paragrafi 1 i nenit 179 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës.
16. Më 30 janar 2019, Gjykata Themelore në Gjiilan (në tekstin e mëtejme: Gjykata Themelore), me Aktgjykimin [PKR. nr. 134/2018] e shpalli fajtor parashtruesin e kërkesës për kryerjen e veprës penale të lartcekur, për të cilën e gjykoi dhe e dënoi me burgim efektiv në kohëzgjatje prej 25 (njëzetepesë) viteve, duke ia llogaritur kohën e kaluar në paraburgim, nga 24 maji 2018 e deri në plotfuqishmërinë e Aktgjykimit.
17. Parashtruesi i kërkesës, brenda afatit ligjor kishte parashtruar ankesë në Gjykatën e Apelit kundër Aktgjykimit të lartcekur të Gjykatës Themelore, për shkak të (i) shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, (ii) shkeljes të ligjit penal, (iii) vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, dhe (iv) vendimit lidhur me sanksionin penal, me propozimin që aktgjykimi i goditur me ankesë të anulohet dhe çështja penale t’i kthehet gjykatës së shkallës së parë, për rigjykim.
18. Më 17 prill 2019, Gjykata e Apelit, me Aktgjykimin [PAKR. nr. 140/2019], refuzoi si të pabazuar ankesën e parashtruesit të kërkesës dhe vërtetoi Aktgjykimin e 30 janarit 2019 të Gjykatës Themelore, duke theksuar se aktgjykimi i goditur: *“nuk përfshihet me shkeljet esenciale për të cilat pretendohet në ankesë se dispozitivi i aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë, është i qartë, i kuptueshëm dhe në harmoni me vetveten, dhe me arsyetimin e të njëjtit, sepse përmban arsyet lidhur me faktet vendimtare, të cilat e karakterizojnë çështjen penale”*.
19. Nga shkresat e lëndës rezulton se parashtruesi i kërkesës ka përmendur Gjykatën Supreme, si instancë gjyqësore e cila ka vendosur për çështjen e tij, por nuk ka dorëzuar një vendim të tillë dhe nuk ka specifikuar as datë dhe as numër të vendimit.

### **Pretendimet e parashtruesit të kërkesës**

20. Parashtruesi i kërkesës pretendon se me vendimet e gjykatave të rregullta i janë shkelur të drejtat dhe liritë themelore të tij të garantuara me Kushtetutë. Në përmbajtje pretendimet ngrenë çështje të procesit të rregullt gjyqësor.
21. Parashtruesi i kërkesës në kërkesën tij thekson se avokati i tij ka dështuar të konsultohet me të, dhe se gjatë seancave ka qenë i pavëmendshëm. Për më tepër, parashtruesi i kërkesës thekson se në seancën e fundit, në të cilën i është komunikuar dënimi, avokati

i tij nuk ka qenë prezent. Tutje, parashtruesi i kërkesës pretendon se vëllai i tij, R. B., gjatë vizitës në qendër të paraburgimit, e ka kërcënuar atë dhe se ka pranuar se ka dhënë dëshmi të rreme. Po ashtu, parashtruesi i kërkesës pohon se kishte rrahur të birin me qëllim të frikësimin dhe këshillimit dhe jo me qëllim për t'i shkaktuar vdekjen.

22. Në fund, parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata që çështjen e tij penale ta kthejë në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë, për të ndriçuar rrethanat faktike dhe provat e rastit, dhe që në riprocedurë të rivendosjes të merret në pyetje i vëllai dhe vajza e tij si dëshmitarë, pasi që deklaratimet e mëparshme, sipas tij, i kanë dhënë nën frikësim të policisë, dhe se vajza e tij ishte frikësuar nga vëllai i tij, me qëllim të ndryshimit të deklaratës.

## Dispozitat relevante

### Ligji

#### Neni 48

(Saktësimi i kërkesës)

*Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj.*

### Rregullorja e punës

#### Rregulli 25

Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve

[...]

(2) Kërkesa, po ashtu, duhet të përmbajë edhe:

[...]

(h) informacionet dhe dokumentacionin mbështetës.

#### Rregulli 54

Hedhja poshtë dhe refuzimi i kërkesës

[...]

(2) Gjykata mund të vendosë ta refuzojë një kërkesë me procedurë të shkurtër në qoftë se:

(a) kërkesa është jo e plotë ose e paqartë, përkundër kërkesës ose kërkesave nga Gjykata ndaj palës që ta plotësojë ose të qartësojë kërkesën;

[...]

## Pranueshmëria e kërkesës

23. Gjykata së pari shqyrton nëse janë përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuar më tej me Ligj dhe Rregullore të punës. Në këtë drejtim, sipas paragrafit 1 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, Gjykata vendos vetëm për rastet e ngritura para Gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar. Ndërsa, sipas paragrafit 7 të të njëjtit nen të Kushtetutës, individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.
24. Përtej kriterëve të përcaktuara më lart, në vlerësimin nëse parashtruesi i kërkesës i plotëson kriteret për vlerësimin e kërkesës së tij, Gjykata rikujton se neni 48 (Saktësimi i kërkesës) i Ligjit specifikisht detyron parashtruesit e kërkesave që të qartësojnë

saktësisht aktin konkret të autoritetit publik të cilin e kontestojnë dhe që të qartësojnë saktësisht se cilat të drejta dhe liri kushtetuese pretendojnë të jenë cenuar. Ndërsa, rregulli 32 (Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve) i Rregullores së punës parasheh që kërkesa e parashtruesve duhet të përmbajë edhe: (a) emrin dhe adresën e palës që parashtron kërkesën; (b) emrin dhe adresën e përfaqësuesit për dorëzimin e dokumenteve, nëse ka; (c) autorizimin për përfaqësuesin ligjor; (d) emrin dhe adresën e palës, ose të palëve kundërshtarë, nëse janë të njohura, të cilave u dërgohen dokumentet; (e) mbrojtjen juridike të kërkuar; (f) përmbledhjen e shkurtër të fakteve; (g) arsyetimin procedural dhe substantiv të kërkesës; dhe (h) informacionet dhe dokumentacionin mbështetës.

25. Në këtë kontekst, sipas paragrafit 4 të nenit 22 (Procedimi i kërkesës) të Ligjit, që parasheh se nëse kërkesa ose përgjigja në kërkesë nuk është e qartë ose e kompletuar, gjyqtari raportues njofton palët apo pjesëmarrësit përkatës për këtë dhe ia cakton një afat prej jo më shumë se pesëmbëdhjetë (15) ditëve për të qartësuar ose plotësuar kërkesën, përkatësisht përgjigjen në kërkesë. Atëherë, kur palët përkatëse, nuk dorëzojnë dokumentacionin e kërkuar në Gjykatë, bazuar në rregullin 35 (Tërheqja, hedhja poshtë dhe refuzimi i kërkesës) të Rregullores së punës, Gjykata mund të vendosë të refuzojë një kërkesë me procedurë të shkurtër, duke marrë parasysh që kërkesa është e paplotë ose e paqartë, përkundër kërkesave të saj ndaj palës që të plotësojnë apo qartësojnë të njëjtën.
26. Në këtë aspekt, Gjykata rikujton se kërkesën e parashtruesit të kërkesës e kishte pranuar më 17 nëntor 2022. Duke marrë parasysh që kërkesa nuk ishte e kompletuar, pasi dosjes nuk i ishte bashkëngjitur vendim i Gjykatës Supreme, Gjykata më 2 dhjetor 2022 kërkoi nga parashtruesi i kërkesës që të dorëzonte vendimin e fundit për rastin e tij, së bashku me dokumentacionin e nevojshëm.
27. Gjykata bazuar në korrespondencën e 22 dhjetorit 2022 dhe fletëkthesën e dorëzuar në Gjykatë nga shërbimi postar, vërtetoi se parashtruesi i kërkesës shkresën e 2 dhjetorit 2022, të ridërguar më 22 dhjetor 2022, e kishte pranuar më 6 janar 2023. Megjithatë, edhe përkundër kërkesës se saj, Gjykata nuk pranoi përgjigje nga parashtruesi i kërkesës brenda afatit të përcaktuar, rrjedhimisht parashtruesi i kërkesës nuk e plotësoi kërkesën e tij.
28. Në këtë kontest, Gjykata nuk mund të shqyrtojë më tej kriteret e pranueshmërisë së kërkesës, të përcaktuara me rregullin 39 të Rregullores së punës, siç është shterimi i mjeteve juridike dhe dorëzimi i kërkesës brenda afatit (4) katërmujor, pasi që kërkesa është e paplotë.
29. Gjykata rikujton se barra për të ndërtuar, sqaruar dhe plotësuar kërkesën bie mbi parashtruesit e kërkesave, të cilët kanë interes të drejtpërdrejtë në mënyrë që pohimet dhe pretendimet e tyre të adresohen në mënyrë efektive nga Gjykata. Në rastet kur parashtruesit e kërkesave nuk i përgjigjen kërkesës së Gjykatës për qartësimin dhe plotësimin e kërkesës, Gjykata, i deklaroi këto kërkesa si të paqarta dhe jo të plota, dhe si rezultat nuk i shqyrton pretendimet e parashtruesve të kërkesave (shih, ndër të tjera, rastet e Gjykatës, [KI121/21](#), me parashtrues *Bajram Hasani*, Vendim për refuzimin e kërkesës, i 23 shtatorit 2021, paragrafi 38, [KI135/21](#), me parashtrues *Isuf Musliu*, Vendim për refuzimin e kërkesës, i 10 shtatorit 2021, paragrafi 35 dhe [KI101/21](#), me parashtrues *N.T.SH. Morina B*, Vendim për refuzimin e kërkesës, i 8 shtatorit 2021, paragrafi 36).

30. Rrjedhimisht, Gjykata konsideron se kërkesa e parashtruesit të kërkesës nuk i përmbush kriteret procedurale për shqyrtim të mëtejshëm, për shkak të moskompletimit me dokumentacion mbështetës, ashtu siç kërkohet me nenet 22.4 dhe 48 të Ligjit dhe me rregullin 25 (2) h) dhe 54 (2) a) të Rregullores së punës. Prandaj, Gjykata përfundon se kërkesa duhet të refuzohet me procedurë të shkurtër.

### PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 të Kushtetutës, me nenet 20, 22 (4) dhe 48 të Ligjit, si dhe në pajtim me rregullat 25 (2) h), 54 (2) a) dhe 48 (1) d) të Rregullores së punës, më 14 nëntor 2023, njëzëri

### VENDOS

- I. TË REFUZOJË kërkesën;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TË PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20 (4) të Ligjit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Gjyqtarja raportuese**

Selvete Gërxhaliu-Krasniqi



**Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese**

Gresa Caka-Nimani